



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

PROCESVERBAL ¹

(I përmbledhur)

Tiranë, më 21.01.2019, ora 15.00

Drejton mbledhjen

Ardian Dvorani – Kryetar i Këshillit

Rendi i Ditës :

1. *Diskutimi dhe miratimi i Projektregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”.*

2. *Diskutim për çështjet e organizimit të punës për përgatitjen, diskutimin dhe miratimin e projektakteve rregullatore, si edhe atyre nënligjore për shortimin e relatorëve, verifikimin dhe vlerësimin e kandidatave për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor të Lartë të Drejtësisë.*

Marrin pjesë :

- | | |
|--------------------------|------------------------|
| 1. Ardian Dvorani | (kryetar) |
| 2. Vitore Tusha | (zëvendës kryetar) |
| 3. Arta Marku | (anëtare) |
| 4. Fatri Islamaj | (anëtar) |
| 5. Margarita Buhali | (anëtare) |
| 6. Fatjona Memçaj | (anëtare) |
| 7. Klodiana Veizi (Mema) | (anëtare zëvendësuese) |
| 8. Medi Bici | (anëtar zëvendësues) |
| 9. Gurali Brahimllari | (anëtar zëvendësues) |

¹ Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja “d”, neni232 pika 2, neni 242 shkronja “c”) dhe Rregullores së Brendshme të Funksionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike diskutimet e vetë anëtarëve të KED për çështjen e rendit të ditës, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe te zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme :

1. Erinda Ballanca, Avokate e Popullit.

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguar në nenin 233/2 të ligjit nr.115/2016 :

1. Bledar Dervishaj, përfaqësues i Presidentit të Republikës.
2. Genci Gjonçaj, përfaqësues i kryetarit të Kuvendit.
3. Ulsi Manja, kryetar i Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, si përfaqësues i maxhorancës në Kuvend.
4. Enkelejd Alibeaj, zëvendëskryetar i Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, si përfaqësues i opozitës në Kuvend.

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga institucionet ndërkombëtare, mbështetëse të procesit të hartimit të akteve nënligjore të KED :

1. Anita Mihailova, eksperte e EURALIUS
2. Klodian Rado, ekspert i EURALIUS
3. Maniela Sota, Koço Bendo, përkthyes për EURALIUS

HAPET MBLEDHJA

Mbledhja fillon në orën 15.00

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, deklaron të hapur mbledhjen.

Verifikohet prania dhe pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit.

Konstatohet mungesa e anëtarit të Këshillit Eriol Roshi.

Ardian Dvorani informon për njoftimin paraprak të anëtarit Eriol Roshi mbi motivin e mungesës, një fatkeqësi familjare, e cila pamundëson pjesëmarrjen në këtë mbledhje.

E pranishme në mbledhje është anëtarja zëvendësuese Klodiana Veizi, e cila, sipas ligjit, e zëvendëson anëtarin Eriol Roshi në rast mungese a pengese ligjore.

Ardian Dvorani lexon çështjet e rendit të ditës të njoftuar paraprakisht :

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

1. Diskutimi dhe miratimi i Projektregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”.

2. Diskutim për çështjet e organizimit të punës për përgatitjen, diskutimin dhe miratimin e projektakteve rregullatorë, si edhe atyre nënligjore për shortimin e relatorëve, verifikimin dhe vlerësimin e kandidaturave për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor të Lartë të Drejtësisë.

Shtrohet për diskutim miratimi i rendit të ditës së paraqitur për këtë mbledhje të Këshillit.

Anëtarët e Këshillit miratojnë pa ndryshime dhe shtesa të tjera rendin e ditës.

Mbledhja e Këshillit vijon me punimet me pikën e parë të rendit të ditës.

Ardian Dvorani paraqet shpjegimet për punën paraprake të zhvilluar për përgatitjen e projektaktit “Rregullore e brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi””, nga grupi i punës me përbërje anëtarë të Këshillit, me mbështetjen dhe asistencën e ekspertëve të EURALIUS, si edhe për mendimet e dhëna paraprakisht nga disa prej anëtarëve të Këshillit për këtë projektakt.

Ardian Dvorani shtron për diskutim mënyrën se si do të procedohet me shqyrtimin e projektaktit, nëse do të diskutohet dhe miratohet në parim për të kaluar më pas në diskutimin dhe miratimin nën për nën të dispozitave të tij apo të kalohet drejtpërdrejt në shqyrtimin e përmbajtjes së dispozitave të projektaktit.

Erinda Ballanca kërkon fjalën dhe parashtron se në mbledhjen e kaluar neve na u dha një dokument mbi bazën e të cilit, në fakt është një dokument fillestar për tu konsultuar dhe unë mbi bazën e atij dokumenti që na është dhënë kam bërë komentet e mija për sa i përket vlefshmërisë së këtij akti. Sot ju kam marrë në telefon dhe kam komunikuar me ju për t’ju thënë ku do t’i dërgojmë komentet në lidhje me atë projektakt të asaj date dhe ju më komunikuat dhe më thatë që kam një material tjetër mbi të cilin, që ne nuk e kemi parë. Unë personalisht, mua nuk më ka ardhur ky material. Duke qenë se funksioni dhe roli i Avokatit të Popullit është i qartë dhe në dispozitat kushtetuese ndryshe nga personat e tjerë, secili prej personave të tjerë mund ta adresojë vetë nëse e vlerëson që duhet të komunikohen aktet e rendit të ditës paraprakisht apo jo. Roli i Avokatit të Popullit në këtë Këshill është i një karakteri jo vetëm formal, po është i karakterit të marrjes pjesë në mbledhje dhe në veprimtari, thotë ligji. Kurse dispozita përkatëse jo një herë po dy herë e përcakton rolin e Avokatit. Si? Për të marrë pjesë jo si i ftuar, për të marrë pjesë me pjesëmarrje të detyrueshme në mbledhje dhe veprimtari. Unë jam shumë e kënaqur që

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

ju ja keni komunikuar Misionit EURALIUS draftin tuaj dhe komentet tuaja, por nuk e kuptoj se për çfarë arsyeje nuk ma keni dërguar edhe mua te një adresë e-mail se u la dakord që do të qarkullonte në këtë mënyrë në mbledhjen e kaluar. Procesverbali nuk është, ndoshta nuk është zbardhur, por kjo është një gjë që lehtësisht mund të verifikohet dhe unë nuk e kuptoj se pse ka ndodhur kjo. Në nenin transparenca është e qartë, në ligj është e qartë se në çfarë niveli është përfaqësimi i Avokatit të Popullit në këtë institucion. Kështu që, nuk e kuptoj se për çfarë arsye të mos na viheshin këto dokumente paraprakisht në dispozicion. Se ju sapo e lkuat që janë dhënë EURALIUSIT dhe shumë mirë që i janë dhënë EURALIUSIT dhe OPDATIT, nuk kam asnjë kundërshtim të asnjë lloji sepse unë gjykoj që transparenca është gjithmonë e rëndësishme.

Unë kam si Avokate e Popullit dy mjete: rekomandime, deklarata për shtyp. A mendoni ju se është normale që unë pas mbledhjes të dal dhe të them që KED-ja nuk bëri në gjykimin tim nuk ka ushtruar kompetencën, ka bërë një, dy, tre, pesë. S'është normale. Ne duhet ta diskutojmë njëherë brenda nesh këtë gjë pa ta bëjmë publike se ky është rezultati eventual dhe më vjen shumë keq që të kemi këtë lloj raporti, kur në mbledhjen e kaluar ishte një frymë tërësisht tjetër. U diskutua, u trajtua, u tha sa më shumë mendime të kemi aq më mirë është dhe dolëm në një diskutim që në fakt nuk duhet të japim mendime. Unë nuk e kuptoj se për çfarë arsye. Të paktën përse i përket atyre dispozitave që kanë të bëjnë me rolin e institucionit tim në këtë grup, unë mendoj se duhej të isha konsultuar. **Ardian Dvorani** shtron për diskutim dhe qëndrim mënyrën se si do të veprohet pas parashtrimeve të Avokatit të Popullit.

Anëtarët e Këshillit diskutojnë dhe shprehin mendimin e tyre.

Në përfundim të diskutimit, **anëtarët e Këshillit** vlerësuan dhe disponuan që, për të garantuar më shumë transparencë dhe kontributin e të gjithë pjesëmarrësve të tjerë në mbledhjen e Këshillit, nisur edhe nga roli që ka përcaktuar për ta Kushtetuta dhe ligji, të shtyhet diskutimi i projektregullores, ti jepet Avokatit të Popullit, por edhe subjekteve të ftuar sipas ligjit, koha e nevojshme për të shqyrtuar versionin më të fundit të projektaktit.

Enkelejd Alibeaj kërkon fjalën dhe parashtron se, sipas ligjit nr. 115/2016, procesverbali i mbledhjes së mëparshme duhet të ishte publikuar, pra është shkelur ligji dhe se, lidhur me ngarkesën e punës edhe për kryerjen e procesit të zbardhjes së procesverbalit, nëse nevojitet, është detyrim i organeve të tjera shtetërore për të mbështetur me mjete dhe personel KED-në. Pjesëmarrja e përfaqësuesve të subjekteve që ftohen dhe veçanërisht e Avokatit të Popullit në mbledhjet dhe veprimtarinë e KED është element garantist për mirëfunksionimin e tij. Mund të

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

kërkohen shërbimet cilësore të OPDAT, EURALIUS etj., por me kushtin ligjor që veprimtaria paraprake e hartimit të projektakteve, gjatë dhe deri në finalizim të tyre, të ketë autorësinë dhe angazhimin e të gjithë anëtarëve të KED, të mbështetur sipas ligjit nga administrata e Gjykatës së Lartë, për të mos lejuar përdorimin e materialeve dhe veprimtarive okulte. Nëse vlerësohet nga Këshilli për të na e vënë në dispozicion në adresën përkatëse të kontaktit, do të jepen edhe mendimet përkatëse mbi projektregulloren.

Ulsi Manja kërkon fjalën dhe parashtron se ligji nr. 115/ 2016 e ka përcaktuar qartësisht mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë dhe vendimarrjes së KED, si organ kolegjal, kushtetues dhe i pavarur. Lidhur me rolin që kanë në KED, ligji është i qartë se Avokati i Popullit merr pjesë në mbledhjet dhe në veprimtarinë e Këshillit, ndërsa subjektet e tjera ftohen nëse e vlerëson Këshilli, për raste dhe çështje të caktuara të rendit të ditës. Mjetet tona të reagimit ndryshojnë nga ato të Avokatit të Popullit, i cili mund të ndërhyjë me rekomandime, deklarata për shtyp etj. Ne mund të reagojmë për transparencën me ndonjë deklaratë për shtyp por rekomandimet gjithmonë mund t'i bëjmë nëpërmjet Avokatit të Popullit. Nëse do të kemi objeksione apo sugjerime, nëse na kërkohen, ua sjellim drejtpërsëdrejti ose nëpërmjet Avokatit të Popullit. Avokatit të Popullit ti jepet koha e nevojshme në dispozicion për tu njohur me versionin e tanishëm të projektregulloreve. Lidhur me autorësinë e materialeve, natyrën dhe rolin mbështetës të institucioneve ndërkombëtare, preferohet që subjektet e ftuar të mos bëhen pjesë e këtij diskutimi sepse nuk duhet të sjellim politikën në veprimtarinë e KED.

Bledar Dervishaj kërkon fjalën dhe parashtron se faktikisht si në pozicionin e të ftuarit në këtë tryezë po të më kërkoni ose nëse ky Këshill do të vendoste të më kërkonte një mendim për rregulloren nuk do mund ta jepja, të them të drejtën dhe të vërtetën, do duresh më shumë kohë që ta lexoja, ta kuptoja dhe të sugjeroja diçka në përmirësimin e tij. Këtë pretendim ngriti dhe Avokati për pak më shumë kohë për të ballafaquar midis draftit që ka dhënë opinion me atë draftin e përmirësuar që sapo kam. Ne jemi dakort ose unë si përfaqësues i Presidentit të Republikës jam plotësisht dakort që t'i jepet një kohë e mjaftueshme, se cila do të jetë kjo kohë do ta vendosni ju, por unë do ju sugjeroj, gjithmonë një sugjerim, që kjo kohë të përkonte edhe me zbardhjen e plotë të atij procesverbalit të mbledhjes së kaluar. Në praktikën e Kuvendit seanca fillon me miratimin e procesverbalit të seancës që shkoi. Ndoshta kjo do i shërbente edhe Avokatit të Popullit për të kujtuar se çfarë dhe si u vendos në mbledhjen e kaluar. Për cilësinë e rregulloreve nuk mund të them dot gjë se edhe unë duhet të marr kohën e nevojshme dhe nëse do

të më kërkohet patjetër që jam i gatshëm të jap opinion, koment sipas kërkesës dhe vlerësimit të Këshillit.

Genci Gjonçaj kërkon fjalën dhe parashtron se Këshilli mund të vlerësojë kohën e nevojshme për të mundësuar përgatitjen e mendimeve nga Avokati i Popullit dhe subjektet e ftuar. Përfaqësuesi i Kryetarit të Kuvendit do të jetë i pranishëm në mbledhjen e Këshillit sa herë të ftohet nga ana ky Këshill dhe për çështje të përcaktuara nga vetë Këshilli.

Ardian Dvorani shtron për diskutim dhe qëndrim të Këshillit përcaktimin e datës së mbledhjes së ardhshme, për të mundësuar edhe kohën e nevojshme që Avokati i Popullit dhe subjektet e ftuar të përgatisin mendimet e tyre lidhur me projektregulloren.

Anëtarët e Këshillit, pasi diskutuan dhe arsyetuan secili qëndrimin e tyre, vendosën që për të mundësuar edhe përgatitjen e mendimeve nga Avokati i Popullit dhe nga subjektet e ftuar lidhur me projektregulloren, mbledhja e ardhshme e Këshillit, me rend dite vijimin e diskutimit dhe miratimit të Projektregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”, të caktohet datën 28.01.2019, në orën 16.00.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani duke shpallur zhvillimin e mbledhjes së radhës në datën 28.01.2019, ora 16.00 me këtë rend dite, deklaroi mbylljen e mbledhjes.

MBLEDHJA MBYLLET NË ORËN 15.57

Sekretari

Kryetari

Redjona Myrtja

Ardian Dvorani

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi